

20180110119

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MATERIAL ARKIVOR

Neni 1

Në Ligjin për material arkivor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 95/12, 41/14, 72/15, 148/15, 169/15 dhe 53/16), në nenin 1-a paragrafi 4 pika 5) në alinenë 4 lidhëza "ose" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me lidhëzën "apo".

Pas alinesë 5 shtohet alineja e re 6, si vijon:

"- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2)".

Pika 6) shlyhet.

Neni 2

Dispozitat e nenit 1-a paragrafi 4 pika 5) të Ligjit për material arkivor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 95/12, 41/14, 72/15, 148/15, 169/15 dhe 53/16), dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji me të cilin neni 1-a paragrafi 4 pika 5) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Drejtori që emërohet në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, obligohet ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Drejtorit i cili nuk do ta përmbushë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".